



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "2A GROUP" Sh.P.K. të datës 04.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) - e ndarë në VI - LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "2A GROUP" Sh.P.K. të datës 04.09.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) - e ndarë në VI - LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "2A Group" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 04.09.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve (fshirja, larja, pastrimi i kanalizimit atmosferik dhe ujëmbledhësve) - e ndarë në VI - LOT-e" me nr. të prokurimit 616-26-6509-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe

nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që gjatë hartimit të kriterëve dhe kërkesave për tenderuesit ka aplikuar kritere që ndikojnë shumë negativisht në drejtim të shfrytëzueshmërisë së mjeteve në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Thënë shtruar, AK ka aplikuar kërkesa dhe nivele të plotësimit të tyre (60%) për liderët e grupeve duke atakuar drejt për drejt efikasitetin dhe ekonomicitetin e shpenzimit të parasë publike si dhe duke atakuar njëkohësisht edhe nenin 71 të LPP-së i cili ua mundëson OE-ve që të futen si Grup të OE-ve në realizimin e kontratave të ndryshme. Përpos kësaj ky AK ka vendosur edhe kritere kufizuese teknike tek pajisjet e nevojshme për realizim të kontratës që shpesh bien në kontradikta të forta me njëra me tjetrën. P.SH. edhe pse pajisjet kanë me u përdorë për operim në një shesh, fushë apo hapësirë të njëjtë, njëres pajisje ja ka vendosur kufirin e peshës maksimale shumë të ulët ndërsa tjetrës shumë të lartë edhe pse të dyja kanë me operuar në të njëjtin vend. Pse u dashka që të kërkohet Fshesë për pastrimin e rrugëve kryesore dhe bulevardeve me peshë totale min 7 deri max 12 ton ndërsa në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend ka me operuar edhe Kamioni (cisternë) speciale me kapacitet (min 9,000 max 20,000) Litra që arrin peshën nga 15 ton deri 30 ton. Pra cili është efekti i kufizimit të peshës maksimale në 12 ton për fshesën kur në të njëjtën hapësirë ka me operuar cisterna me peshë të mundshme deri në 30 ton. Kjo po shihet qartë se është bërë vetëm për kufizim të konkurrencës me efekt favorizimin e OE-ve që AK paraprakisht ua ka shikuar pajisjet dhe kapacitetet e peshave të tyre. Kjo shkon aq larg sa që për nivele të rrugëve të njëjta me kapacitet bartës të njëjtë, diku vendosë pesha më të vogla e diku më të larta, që tregon se përmes favorizimeve të tilla edhe ua ka nda Lot-et OE-ve të caktuar në përputhje me kapacitetet teknike që ata i posedojnë. Aty ku operon fshesa 12 ton, mund të operoj edhe fshesa 13 ton me që në të njëjtin vend operon cisterna me 30 ton, prandaj kjo tregon hapur se ka kufizime të qëllimshme me qëllim favorizimin e OE-ve të caktuar.

Përpos krejt këtyre, AK ka bërë kufizime edhe tek dokumentacioni dëshmues i pajisjeve me që ka kërkuar që ato të dëshmohen me librezë të regjistrimit me validitet ose për disa edhe me DUD-a doganor. Fillimisht këtu ka bërë kufizim në detyrim të panevojshëm të regjistrimit të pajisjeve para se të fitohet kontrata e që shpenzimi i tillë ndikon direkt në rritjen e kostos për AK-në sepse kosto e tillë reflekton tek çmimet që do ofrohen. Përpos kësaj ka bërë kufizime edhe kur për disa pajisje ka kërkuar DUD-a doganor që tregon se drejt për drejt ua ka kufizuar pjesëmarrjen kompanive që për momentin operojnë në shtetet tjera. Pra edhe pse tenderi është tender i madh me mundësi të tenderimit edhe kompanitë nga vendet fqinje, përmes kërkesës për DUD-a doganor ua ka pamundësuar pjesëmarrjen në këtë aktivitet. Për ta plotësuar këtë dhe për të dëshmuar se veprimet e tilla janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 6 të LPP-së po i paraqesim dy dispozita decitive që e ndalojnë veprimin e tillë të AK-së:

Neni 1

Qëllimi

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6

Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Pretendimi 2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kriterëve dhe kërkesave për OE ka vendosur kriterë kufizuesë për shumicën e OE-ve dhe favorizuesë për disa OE të caktuar në të njëjtën kohë. Ky veprim i AK-së bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh edhe me nenin 27 dhe 69 të LPP-së që flasin për procedurat e prokurimit për shërbime. LPP dhe RRPP-001/2022 qartë e përcakton që kriteret dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga OE duhet të jenë të qarta dhe të paraqiten si kriterë minimale, të definuara saktë dhe të matshme, e jo siç i ka vendosur AK-ja në rastin konkret. Bazuar në këtë dhe shikuar me kujdes kërkesën që Lideri i grupit të ketë 60% të pajisjeve, kërkesa që pajisjet të dëshmohen me librezë valide apo me DUD-a doganor tek disa pajisje si dhe kufizimet në pajisje me pesha minimale dhe maksimale në të njëjtën kohë, tregon qartë se AK ka bërë qëllimisht kufizim konkurrence duke favorizuar OE të caktuar që fillimisht ua ka shikuar pajisjet që ata posedojnë e mandej ua ka përshtatur ndarjen e tyre madje edhe në Lot-e që si veprim bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 3. nenin 4 të RRPP-001/2022 i cili flet për administrimin e mirëfilltë të procedurave të prokurimit dhe luajtjen e rolit aktiv të AK-së në shfrytëzimin e parasë publike në mënyrë efikase dhe ekonomike. Ja si e përshkruan detyrimin e AK në vendosjen e kriterëve proporcionale dhe të drejtë a nenin 4 i kësaj rregulloreje:

Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

- a. të luaj rol in aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasi, karakteristikat teknike dhe garancive;
- b. për aq sa është e mundur në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe
- c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Po që se e shikojmë me kujdesë dosjen e tenderit dhe kërkesat e vendosura nga AK e sidomos kriterin që lideri të posedoj 60% të pajisjeve, dëshmimi i pajisjeve me librezë valide dhe me DUD-a doganor si dhe kufizimet e peshave tek pajisjet nga të dy nivelet, ai minimal dhe ani maksimal, tregojnë se AK nuk është duke administruar fare procedurën e prokurimit sipas këtij neni nga çka lirisht mund të themi se edhe e ka shkelur nenin e tillë.

Pretendimi 4. AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 me rastin e hartimit të dosjes së tenderit sepse ka lënë kërkesa kufizuese edhe përkundër që LPP me dispozitat a tijë ja ndalon një gjë të tillë kërkesa e tillë duke e udhëzuar AK-në për hartim të kriterëve në përputhje me frymën dhe parimin e drejtë të prokurimit si dhe rritjes/promovimit së konkurrencës. Vet fakti që AK ka lënë kriterë të cilat është jashtëzakonisht vështirë të plotësohen nga një OE i vetë si dhe janë shumë të kushtueshëm që të plotësohet, sidomos për ata që duan të aplikojnë në më shumë Lot-e, tregon se hartimi i dosjes është bërë në kundërshtim me ligjin përkatësisht në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 17 të RRPP-së.

- ❖ Kërkesa e Aneksit 8 me dy kufizime (min dhe max) në kapacitet teknik(peshë, litrazhë apo presion, etj), P.SH.:

Fshesë për pastrimin e rrugëve kryesore dhe bulevardeve me peshë totale min 7 deri max 12 ton : sistem pastrimi me furça dhe vakum me fuqi të lartë , e përshtatshme për përdorim në rrugë me trafik të lartë, gjendje teknike funksionale.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast janë kërkuar sqarime pikërisht nga njësia kërkuese të cilave u është falur besimi i plotë. Sqarime e ofruara nga njësia kërkuese lidhur me pretendimet ankimore janë si në vijim:

“

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të plotë të Kërkesës për Rishqyrtim të paraqitur nga 2A GROUP SH.P.K., më datë 04.09.2026, ka shqyrtuar në mënyrë të veçantë secilin pretendim të ngritur nga ankuesi, kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, versionin e korrigjuar të publikuar më 28.08.2026, rekomandimin e KRPP-së të datës 27.08.2026, dokumentacionin mbi përcaktimin e nevojave, territorin dhe karakteristikat operative të LOT-I, si dhe arsyetimet teknike për secilën kategori të mekanizimit të kërkuar. Pas këtij shqyrtimi, Autoriteti Kontraktues konstaton se pretendimet e Operatorit Ekonomik nuk kanë arritur të dëshmojnë me argumente konkrete, prova teknike, të dhëna të verifikueshme ose analizë funksionale se kërkesat e përcaktuara në LOT-I janë të paligjshme, joproporcionale, diskriminuese ose të shkëputura nga objekti dhe nevojat reale të kontratës. Përkundrazi, AK konstaton se kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit janë rezultat i vlerësimit të nevojave të kontratës dhe janë përcaktuar duke marrë parasysh llojin dhe shtrirjen e shërbimeve, karakteristikat e territorit të LOT-I, strukturën e rrjetit rrugor, dimensionet dhe tipologjinë e hapësirave publike, shtigjet e biçikletave, trotualet, bulevardet, rrugët urbane, kanalizimin atmosferik, nevojën për intervenim në hapësira të ngushta, sigurinë e përdoruesve të rrugës dhe këmbësorëve, si dhe nevojën për vazhdimësi dhe efikasitet të shërbimit. Autoriteti Kontraktues thekson se qëllimi i përcaktimit të parametrave teknikë nuk është kufizimi i konkurrencës, por siguri që operatori ekonomik i cili do të kontraktohet të jetë realisht në gjendje ta realizojë tërësinë e shërbimeve të kërkuara në kushtet konkrete të LOT-I. Në këtë kuptim, konkurrenca në prokurimin publik nuk mund të interpretohet si detyrim i Autoritetit Kontraktues për t'i përshtatur specifikimet teknike me pajisjet që posedon një operator ekonomik i caktuar. Përkundrazi, specifikimet duhet të burojnë nga nevoja reale dhe objektive e kontratës, duke respektuar njëkohësisht parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Neni 9 i LPP-së e lidh fillimin e aktivitetit të prokurimit me përcaktimin e nevojave që duhet të përmbushen, ndërsa Neni 27 kërkon që këto nevoja dhe specifikimet teknike të reflektohen në Dosjen e Tenderit. Neni 28 kërkon që specifikimet teknike të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe, në të njëjtën kohë, lejon përdorimin e kërkesave të ekzekutimit dhe funksionalitetit. Po ashtu, Neni 69 i LPP-së i mundëson Autoritetit Kontraktues që, për qëllime të vlerësimit të aftësisë teknike dhe profesionale, të kërkojë dëshmi lidhur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike në dispozicion për realizimin e shërbimeve, kur këto janë të lidhura me objektin dhe natyrën e kontratës. Për rrjedhojë, AK

nuk e ka trajtuar këtë kërkesë si një çështje të thjeshtë të preferencës së një peshe apo dimensionit, por si pjesë të kapacitetit real teknik dhe operacional të nevojshëm për realizimin e shërbimit. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka marrë parasysh rekomandimin e KRPP-së të datës 27.08.2026 dhe ka rishikuar formulimin e kërkesave teknike, duke i paraqitur parametrat në formën e minimumit dhe maksimumit dhe duke i shoqëruar ato me përshkrimin e përdorimit dhe funksionit të pajisjeve. Kjo dëshmon se AK nuk ka vepruar në mënyrë arbitrare, por ka reaguar ndaj vërejtjeve të organit kompetent dhe ka ndërmarrë masa për ta bërë specifikimin më të qartë dhe më të verifikueshëm. Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues nuk gjen bazë faktike apo juridike për pranimin e kërkesës së 2A GROUP për ndryshimin e kërkesave teknike të LOT-I, përderisa ankuesi nuk ka dëshmuar se parametrat e përcaktuar nuk janë të nevojshëm, nuk janë funksionalisht të arsyeshëm ose se ekziston një alternativë konkrete që garanton të njëjtin rezultat operacional pa cenuar sigurinë, qasjen, efikasitetin dhe vazhdimësinë e shërbimit.

2. RESPEKTIMI I REKOMANDIMIT TË KRPP-SË

Autoriteti Kontraktues, para shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga Operatori Ekonomik 2A GROUP SH.P.K., e konsideron të nevojshme të sqarojë në mënyrë të plotë kronologjinë e veprimeve të ndërmarra gjatë këtij aktiviteti të prokurimit, me qëllim që të dëshmohet se përcaktimi dhe më pas riformulimi i kërkesave teknike nuk është bërë në mënyrë arbitrare, por në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe me rekomandimin e dhënë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP).

Fillimisht, Autoriteti Kontraktues ka hartuar Dosjen e Tenderit dhe ka përcaktuar kërkesat teknike në bazë të nevojave të identifikuara për realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së rrugëve dhe hapësirave publike sipas LOT-I. Këto kërkesa kanë qenë të lidhura me natyrën, shtrirjen dhe kompleksitetin e shërbimeve që duhet të realizohen. Pas ngritjes së çështjeve lidhur me specifikimet teknike, Autoriteti Kontraktues ka marrë parasysh procedurën e shqyrtimit nga KRPP dhe nuk ka injoruar, anashkaluar apo refuzuar rekomandimin e këtij institucioni. Përkundrazi, pas pranimit të rekomandimit të KRPP-së të datës 27.08.2026, Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë veprimet përkatëse dhe ka bërë rishikimin e formulimit të kërkesave teknike në përputhje me vërejtjet e paraqitura. Konkretisht, në versionin e rishikuar të Dosjes së Tenderit, të publikuar më 28.08.2026, Autoriteti Kontraktues ka bërë ndryshimet përkatëse në mënyrën e paraqitjes së parametrave teknike, duke i riformuluar kërkesat dhe duke i paraqitur ato në mënyrë më të qartë për operatorët ekonomikë.

Kjo kronologji është me rëndësi të veçantë, sepse dëshmon se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në frymën e transparencës, përgjegjshmërisë dhe respektimit të udhëzimeve të organeve kompetente të sistemit të prokurimit publik. Rrjedhimisht, pretendimi eventual i ankuesit se Autoriteti Kontraktues ka vazhduar të njëjtën kërkesë pa marrë parasysh rekomandimin e KRPP-së nuk qëndron. Autoriteti Kontraktues e ka marrë rekomandimin në konsideratë dhe ka bërë ndryshimet përkatëse në Dosjen e Tenderit brenda afatit dhe në mënyrën e kërkuar. Po ashtu, duhet bërë një dallim i qartë ndërmjet respektimit të rekomandimit të KRPP-së dhe pranimit automatik të çdo kërkesë të mëvonshme të një operatori ekonomik. Fakti se AK ka rishikuar Dosjen e Tenderit në bazë të rekomandimit të KRPP-së nuk nënkupton se pas këtij rishikimi çdo operator ekonomik ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e mëtejshëm të çdo parametri teknik vetëm mbi bazën e preferencës së tij. Pas rishikimit të Dosjes së Tenderit, parametrat teknike duhet të vlerësohen sipas versionit aktual dhe të arsyetuar të Dosjes së Tenderit. Në këtë fazë, çdo pretendim i operatorit ekonomik duhet të mbështetet në argumente konkrete dhe të verifikueshme se kërkesa aktuale është në kundërshtim me LPP-në, është e palidhur me objektin e kontratës, është joproporcionale ose krijon kufizim të pajustificuar të konkurrencës. Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues konsideron se rekomandimi i KRPP-së është respektuar dhe se rishikimi i Dosjes së Tenderit ka adresuar çështjet e ngritura në atë rekomandim. Për këtë arsye, nuk mund të barazohet versioni fillestar i Dosjes së Tenderit me versionin e rishikuar, pasi pas rekomandimit të KRPP-së AK ka ndërmarrë veprimet konkrete për përmirësimin dhe qartësimin e kërkesave. Për më tepër, vetë fakti që AK ka pranuar të rishikojë formulimin e Dosjes së Tenderit pas rekomandimit të KRPP-së dëshmon se qëllimi i AK-së nuk ka qenë kufizimi i konkurrencës apo favorizimi i një operatori ekonomik, por siguri i një procedure të rregullt dhe i kërkesave teknike të qarta, të verifikueshme dhe të lidhura me nevojat e kontratës. Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues vlerëson se

pretendimet që mbështeten në versionin fillestar të specifikimeve, pa marrë parasysh ndryshimet e bëra pas rekomandimit të KRPP-së, nuk mund të shërbejnë si bazë për anulimin ose ndryshimin e versionit aktual të Dosjes së Tenderit. Rrjedhimisht, AK konstaton se veprimet e ndërmarra pas rekomandimit të KRPP-së janë në përputhje me obligimin e saj për të shqyrtuar dhe adresuar vërejtjet e ngritura, ndërsa kërkesat e mbetura në versionin aktual të Dosjes së Tenderit do të arsyetohen veçmas, sipas nevojës konkrete dhe funksionit të secilës pajisje.

3. KUADRI LIGJOR QË RREGULLON VENDIMARRJEN E AK-së

Autoriteti Kontraktues, gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit, përcaktimit të kërkesave për aftësi teknike dhe profesionale dhe specifikimeve teknike për LOT-I, ka vepruar në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi që i janë dhënë me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me ndryshimet dhe plotësimet përkatëse, si dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Vendimarrja e AK-së nuk është bazuar në preferenca subjektive apo në interesat e një operatori ekonomik të caktuar, por në përcaktimin e nevojave reale të kontratës, natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve, kushtet konkrete në të cilat do të realizohet kontrata dhe kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin e saj. Neni 9 i LPP-së – Parimet e Përgjithshme dhe dispozitat përkatëse mbi përcaktimin e nevojave dhe planifikimin e prokurimit obligojnë Autoritetin Kontraktues që aktivitetin e prokurimit ta zhvillojë në funksion të përmbushjes së nevojave të tij reale dhe të interesit publik. Në rastin konkret, nevoja e AK-së është sigurimi i mirëmbajtjes së vazhdueshme, efikase dhe të sigurt të rrjetit rrugor dhe hapësirave publike të përfshira në LOT-I. Neni 27 i LPP-së – Dosja e Tenderit përcakton se Dosja e Tenderit duhet të përmbajë informacionin, kushtet, kërkesat dhe specifikimet teknike të nevojshme për zhvillimin e procedurës dhe realizimin e kontratës. Për rrjedhojë, AK nuk mund të përcaktojë vetëm në mënyrë të përgjithshme se dëshiron të blejë një shërbim; ajo duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë se çfarë shërbimi kërkon dhe çfarë kapaciteti teknik nevojitet për realizimin e tij. Në këtë kuptim, Neni 28 i LPP-së – Specifikimet Teknike është dispozita kryesore që rregullon kompetencën e AK-së për përcaktimin e kërkesave teknike. Specifikimet duhet të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe nuk duhet të hartohen në mënyrë që favorizon ose diskriminon operatorë ekonomikë. Në të njëjtën kohë, ligji lejon përcaktimin e kërkesave përmes standardeve, karakteristikave teknike, si dhe kërkesave të ekzekutimit dhe funksionalitetit, kur këto janë të lidhura me objektin e kontratës. Prandaj, fakti që një specifikim teknik mund të krijojë një dallim ndërmjet pajisjeve të ndryshme nuk e bën atë automatikisht diskriminues. Ajo që duhet të vlerësohet është nëse dallimi është i lidhur me objektin e kontratës, nëse ekziston një nevojë objektive për të dhe nëse kërkesa është e arsyeshme dhe proporcionale me rezultatin që AK synon ta arrijë. Po ashtu, Neni 69 i LPP-së – Kapaciteti Teknik dhe Profesional i mundëson Autoritetit Kontraktues që, në varësi të natyrës së kontratës, të kërkojë dëshmi për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, përfshirë informacionin dhe dëshmitë lidhur me mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike në dispozicion për realizimin e shërbimit. Kjo dispozitë është veçanërisht relevante për këtë aktivitet prokurimi, pasi objekti i kontratës nuk është një shërbim që mund të realizohet vetëm përmes deklaratimit të kapacitetit njerëzor, por kërkon përdorimin e një numri dhe lloji të caktuar të mekanizimit për realizimin e shërbimeve në terren. Për këtë arsye, përcaktimi i pajisjeve teknike në Dosjen e Tenderit është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me aftësinë e operatorit ekonomik për ta realizuar atë në mënyrë efektive. Në të njëjtën kohë, Autoriteti Kontraktues ka respektuar parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, mosdiskriminimin, transparencën, konkurrencën dhe proporcionalitetin. Kërkesat janë përcaktuar në mënyrë të përgjithshme dhe objektive dhe nuk janë lidhur me emrin tregtar, markën, prodhuesin apo një operator ekonomik të caktuar. Në rastin konkret, AK nuk ka kërkuar një pajisje të një prodhuesi të caktuar, por ka përcaktuar parametra teknike dhe funksionale që duhet t'i përmbushë pajisja, me qëllim që ajo të jetë e përshtatshme për kushtet konkrete të punës në LOT-I. Për më tepër, gjatë përcaktimit të kërkesave teknike, AK ka pasur parasysh edhe parimin e proporcionalitetit, në kuptimin që kërkesa duhet të jetë e lidhur me objektin e kontratës dhe të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të prokurimit. Për këtë arsye, secila kategori e pajisjeve të kërkuara në LOT-I duhet të lexohet në raport me funksionin konkret që duhet të kryejë dhe kushtet në të cilat do të përdoret, dhe jo vetëm në raport me një parametër të izoluar teknik. Është

gjithashtu e rëndësishme të theksohet se kompetenca e AK-së për përcaktimin e nevojave teknike nuk zëvendësohet nga preferenca teknike e një operatori ekonomik. Operatorët ekonomikë kanë të drejtë të kërkojnë sqarime dhe të kundërshtojnë specifikimet sipas procedurave të përcaktuara me LPP, mirëpo fakti që një operator ekonomik do të preferonte një parametër tjetër teknik nuk përbën në vetvete dëshmi se parametri i përcaktuar nga AK është i paligjshëm. Autoriteti Kontraktues është institucioni që mban përgjegjësinë për përcaktimin e nevojës publike dhe për sigurimin e shërbimit që duhet të kontraktohet. Për këtë arsye, vlerësimi teknik i AK-së duhet të bazohet në nevojën reale të kontratës dhe në rezultatet që kërkohet të arrihen, ndërsa ndërhyrja në specifikimet teknike justifikohet vetëm kur dëshmohet se kërkesa është në kundërshtim me ligjin, nuk ka lidhje me objektin e kontratës ose vendos një kufizim të pajustificueshëm dhe joproporcional të konkurrencës. Në rastin konkret, 2A GROUP SH.P.K. nuk ka dëshmuar se kërkesat teknike të LOT-I janë të përcaktuara për një operator ekonomik të caktuar, për një markë ose prodhues të caktuar, apo se ato janë të shpëputura nga nevojat reale të shërbimit. Pretendimet e ankuesit, në masën që synojnë zëvendësimin e parametrave të përcaktuar nga AK me parametra të tjerë të preferuar prej tij, nuk mund të konsiderohen si dëshmi e mjaftueshme e shkeljes së LPP-së. Përkundrazi, AK ka ndërtuar kërkesat teknike mbi nevojat operative të LOT-I dhe ka marrë masa për rishikimin dhe qartësimin e tyre pas rekomandimit të KRPP-së, siç është elaboruar në pikën II të kësaj përgjigjeje. Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kuadri ligjor i prokurimit publik i jep bazë të mjaftueshme për përcaktimin e kërkesave teknike dhe të kapacitetit teknik/profesional, përderisa këto kërkesa janë të lidhura me objektin e kontratës, janë objektive, transparente, proporcionale dhe zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Për këto arsye, AK e konsideron të pabazuar çdo pretendim sipas të cilit përcaktimi i parametrave teknikë në LOT-I, vetëm për shkak se nuk përputhet me specifikimet ose pajisjet e preferuara nga ankuesi, përbën shkelje të LPP-së. AK thekson se prokurimi publik nuk është proces në të cilin Autoriteti Kontraktues identifikon fillimisht inventarin e operatorëve ekonomikë dhe më pas harton kërkesat sipas pajisjeve që ata posedojnë. Logjika është e kundërt: AK identifikon nevojën publike, përcakton objektin dhe kërkesat minimale të nevojshme për realizimin e kontratës, ndërsa operatorët ekonomikë vendosin nëse janë në gjendje t'i përmbushin këto kërkesa. Përderisa kërkesat janë të lidhura me objektin e kontratës, të arsyeshme, proporcionale dhe të zbatueshme në mënyrë të barabartë, fakti që një operator ekonomik nuk i posedon pajisjet e kërkuara nuk e bën kërkesën të paligjshme.

4. PARIMI QENDROR: NEVOJA E KONTRATËS, JO INVENTARI I OPERATORIT

Autoriteti Kontraktues thekson se, gjatë hartimit të specifikimeve teknike dhe përcaktimit të kapaciteteve të nevojshme për realizimin e LOT-I, pikënisja ka qenë nevoja reale e kontratës dhe jo inventari, kapaciteti ekzistues apo struktura e mekanizimit në dispozicion të një operatori ekonomik të caktuar. Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit është sigurimi i mirëmbajtjes së rrugëve dhe hapësirave publike të përfshira në LOT-I. Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues ka pasur për detyrë të identifikojë paraprakisht nevojat reale të territorit, llojin e ndërhyrjeve që duhet të realizohen, kushtet konkrete të terrenit dhe kapacitetet teknike të nevojshme për sigurimin e shërbimit të kërkuar. Në këtë kuptim, specifikimet teknike nuk janë hartuar duke u nisur nga pyetja se çfarë pajisjesh posedojnë operatorët ekonomikë, por nga pyetja se cilat pajisje janë të nevojshme për realizimin e plotë, të sigurt dhe efikas të kontratës. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta përshtatë nevojën e tij publike me inventarin ekzistues të një operatori ekonomik. Një qasje e tillë do të nënkuptonte që kërkesat e Dosjes së Tenderit të përcaktoheshin nga kapacitetet e operatorëve ekonomikë dhe jo nga nevojat e institucionit dhe të qytetarëve të cilëve u ofrohet shërbimi. Përkundrazi, logjika e këtij aktiviteti është që AK përcakton nevojën, funksionin dhe kapacitetin minimal të nevojshëm për realizimin e kontratës, ndërsa operatorët ekonomikë vlerësojnë nëse i përmbushin këto kërkesa dhe nëse kanë kapacitetin për të marrë përsipër realizimin e kontratës. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e LOT-I, për shkak të karakteristikave të veçanta të territorit që mbulohet nga ky lot. Bëhet fjalë për një zonë urbane me kombinim të rrugëve të kategorive të ndryshme, bulevardëve, trotuareve, shtigjeve të biçikletave, shesheve dhe hapësirave të tjera publike, të cilat nuk kanë të njëjtat karakteristika fizike dhe nuk mund të mirëmbahen domosdoshmërisht me të njëjtën kategori të mekanizimit. Për këtë arsye, AK ka përcaktuar kategori të ndryshme të pajisjeve, duke pasur parasysh funksionin konkret që duhet të kryejë secila pajisje dhe kushtet

në të cilat ajo duhet të operojë. Fakti se një operator ekonomik posedon një pajisje tjetër, të ndryshme nga ajo e kërkuar në Dosjen e Tenderit, nuk është në vetvete dëshmi se pajisja e kërkuar nga AK është e panevojshme. Po kështu, fakti se operatori ekonomik mund të kryejë një pjesë të shërbimit me pajisjet që posedon nuk dëshmon se ai mund të realizojë tërësinë e shërbimeve të kontratës në të gjitha kushtet konkrete të përcaktuara nga AK. Autoriteti Kontraktues është i interesuar të sigurojë jo vetëm mundësinë teorike të kryerjes së një pune, por aftësinë reale për të kryer të gjitha shërbimet e parapara në kontratë, në kohën e kërkuar, në vendin e kërkuar dhe me mjetin teknik të përshtatshëm për kushtet konkrete të terrenit. Në këtë drejtim, një pajisje nuk mund të konsiderohet automatikisht zëvendësuese e një pajisjeje tjetër vetëm për shkak se të dyja mund të kryejnë në mënyrë të përgjithshme një veprim të ngjashëm. Për vlerësimin e përshtatshmërisë duhet të merret parasysh funksioni, kapaciteti, dimensionet, manovrueshmëria, qasja, siguria, produktiviteti dhe kushtet konkrete të operimit. Për shembull, fakti se një fshehtësi më e madhe mund të kryejë pastrimin e një sipërfaqeje rrugore nuk do të thotë automatikisht se ajo mund të zëvendësojë një fshehtësi kompakte për një shteg biçikletash ose hapësirë të kufizuar urbane. Në mënyrë të njëjtë, një pajisje me kapacitet tjetër teknik nuk mund të konsiderohet ekuivalente vetëm sepse, në teori, mund të kryejë një pjesë të funksionit. Kërkesa e AK-së duhet të vlerësohet në raport me të gjithë objektin e kontratës dhe jo në raport me inventarin e operatorit që e kundërshton atë. AK e pranon se specifikimet teknike nuk mund të jenë arbitrare, të panevojshme ose të orientuara drejt një operatori, marke apo prodhuesi të caktuar. Për këtë arsye, parametrat e përcaktuar në Dosjen e Tenderit janë ndërtuar mbi bazën e nevojave operative të kontratës dhe duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Në rastin konkret, nuk është kërkuar markë, prodhues apo model i caktuar. Janë përcaktuar karakteristika dhe kapacitete teknike, të cilat AK i konsideron të nevojshme për realizimin e shërbimit. Për rrjedhojë, nëse një operator ekonomik nuk e posedon një pajisje të caktuar ose posedon një pajisje me karakteristika të ndryshme, kjo çështje i përket kapacitetit të tij për të përmbushur kërkesat e aktivitetit të prokurimit, dhe nuk mund të jetë vetvetiu bazë për detyrimin e AK-së që të ndryshojë nevojat teknike të kontratës. Për më tepër, ndryshimi i kërkesave vetëm për t'iu përshtatur pajisjeve ekzistuese të një operatori do të mund të krijonte një precedent të papërshtatshëm, ku secili operator ekonomik do të mund të kërkonte modifikimin e specifikimeve sipas mekanizimit që posedon. Kjo do të cenonte vetë qëllimin e specifikimeve teknike dhe do ta zhvendoste fokusin nga nevoja publike tek interesi individual i operatorit ekonomik. Prandaj, Autoriteti Kontraktues konsideron se pretendimet e Operatorit Ekonomik duhet të shqyrtohen mbi bazën e një pyetjeje objektive: A janë kërkesat e përcaktuara nga AK të lidhura me objektin dhe nevojat reale të kontratës dhe a janë të arsyeshme e proporcionale për realizimin e saj? Jo mbi bazën e pyetjes nëse një operator i caktuar i posedon aktualisht këto pajisje. Në rastin konkret, AK do të demonstrojë në vijim, për secilën pajisje të kundërshtuar nga ankuesi, nevojën konkrete operative, funksionin që duhet të realizohet, karakteristikat e terrenit dhe arsyen teknike për përcaktimin e parametrit përkatës. Për këtë arsye, pretendimi se kërkesa duhet të ndryshohet vetëm për shkak se operatori ekonomik mund të ofrojë një pajisje tjetër, nuk përbën bazë të mjaftueshme për ndryshimin e Dosjes së Tenderit, përderisa kërkesa e AK-së është e lidhur me objektin e kontratës, është objektive, proporcionale dhe aplikohet në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë. Në përfundim, AK thekson se specifikimi teknik duhet t'i përgjigjet nevojës së kontratës dhe jo inventarit të operatorit ekonomik. Është nevoja reale e LOT-I ajo që përcakton mekanizimin e domosdoshëm, ndërsa jo kapaciteti ekzistues i një operatori të veçantë.

5. LOT-I - NATYRA SPECIFIKE E TERRITORIT DHE NEVOJAT OPERATIVE

Autoriteti Kontraktues thekson se vlerësimi i pretendimeve të Operatorit Ekonomik nuk mund të bëhet në mënyrë abstrakte dhe të shkëputur nga territori konkret për të cilin është hartuar LOT-I.

LOT-I përfshin territorin qendror dhe zonat kryesore urbane të Prishtinës, duke përfshirë rrugë kryesore, bulevarde, trotuare, sheshe dhe hapësira publike, segmente me shtigje të biçikletave, rrugë urbane me karakteristika të ndryshme, pika të grumbullimit të mbeturinave dhe infrastrukturë të kanalizimit atmosferik. Për rrjedhojë, territori i LOT-I nuk paraqet një sipërfaqe homogjene ku të gjitha shërbimet mund të realizohen me një kategori të vetme të mekanizimit. Përkundrazi, kushtet fizike, dimensionet, funksioni dhe niveli i përdorimit të këtyre hapësirave ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme, dhe kjo ka qenë një

nga bazat kryesore për përcaktimin e mekanizimit të kërkuar. Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar mekanizimin vetëm mbi bazën e sipërfaqes së përgjithshme që duhet të pastrohet, por ka marrë parasysh edhe llojin e sipërfaqes, gjerësinë e hapësirës, mundësinë e qasjes, nevojën për manovrim, intensitetin e trafikut, sigurinë e përdoruesve, shpejtësinë e kërkuar të ndërhyrjes dhe funksionin që duhet të realizojë secila pajisje. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për qendrën e Prishtinës, ku mirëmbajtja e hapësirave publike nuk mund të trajtohet njësoj si mirëmbajtja e një rruge periferike ose e një segmenti rrugor me karakteristika krejtësisht të ndryshme. Në territorin e LOT-I ndërthuren rrugë të kategorive të ndryshme me trotuare, shtigje biçikletash, sheshe dhe hapësira të tjera publike, ndërsa në shumë prej këtyre zonave ekziston frekuentimi i lartë i këmbësorëve dhe përdoruesve të tjerë. Për këtë arsye, AK ka konsideruar të nevojshme që mekanizimi të jetë i përshtatshëm për secilën nga këto situata operative dhe jo vetëm për një pjesë të territorit. Për shembull, një mjet i dimensioneve të mëdha mund të jetë shumë efikas në një bulevard të gjerë, por kjo nuk do të thotë se i njëjti mjet është po aq i përshtatshëm për një shteg të ngushtë biçikletash ose një hapësirë urbane ku kërkohet manovrim i shpejtë dhe i sigurt. Në mënyrë të njëjtë, një mjet kompakt i përshtatshëm për shtigje dhe hapësira të ngushta nuk mund të konsiderohet automatikisht zëvendësim për një mjet me kapacitet më të madh të destinuar për pastrimin e sipërfaqeve të mëdha rrugore. Kjo është arsyeja pse AK ka përdorur kategori të ndryshme të mekanizimit dhe jo një specifikim të vetëm për të gjitha shërbimet. Diferencimi i pajisjeve sipas funksionit nuk përbën diskriminim në vetvete. Përkundrazi, ai është rezultat i nevojës për të siguruar që secila pjesë e territorit dhe secili lloj shërbimi të mund të mbulohet me mjetin e përshtatshëm. Në këtë kuptim, një krahasim i izoluar i një parametri teknik ndërmjet dy pajisjeve, apo ndërmjet dy LOT-eve të ndryshme, nuk mund të përdoret si provë se specifikimi i LOT-I është i panevojshëm. Secili LOT është përcaktuar në raport me territorin, nevojat dhe kushtet operative që duhet të mbulojë. Prandaj, fakti se në një LOT tjetër është përcaktuar një peshë, kapacitet ose konfigurim tjetër i një makinerie nuk krijon detyrim që i njëjti parametër të aplikohet edhe në LOT-I. Në rastin konkret, dallimet ndërmjet pajisjeve të kërkuara janë rezultat i dallimeve reale në funksionin që duhet të realizojnë dhe në kushtet e operimit, dhe jo rezultat i ndonjë trajtimi të ndryshëm të operatorëve ekonomikë. Autoriteti Kontraktues ka pasur gjithashtu parasysh se mirëmbajtja e territorit qendror kërkon vazhdimësi të shërbimit dhe aftësi për reagim në situata të ndryshme, pasi dështimi i një kategorie të vetme të mekanizimit mund të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimit publik. Për këtë arsye, AK nuk ka kërkuar "më shumë makineri" për qëllim të kufizimit të konkurrencës, por ka kërkuar kategori të ndryshme të makinerive për funksione të ndryshme që dalin nga vetë natyra e territorit dhe objektit të kontratës. Kjo qasje është veçanërisht e arsyeshme për LOT-I, pasi bëhet fjalë për një territor me rëndësi të veçantë urbane, ku çdo ndërhyrje duhet të kryhet në mënyrë të sigurt, efikase dhe pa krijuar pengesa të panevojshme për qarkullimin e automjeteve, këmbësorëve dhe biçiklistëve. Për rrjedhojë, vlerësimi i nevojës për secilën pajisje duhet të bëhet në raport me funksionin konkret që ajo duhet të realizojë në LOT-I dhe jo vetëm në bazë të ekzistencës së një pajisjeje tjetër që mund të kryejë një funksion të ngjashëm në kushte të tjera. AK do të paraqesë në vijim, për secilën prej pajisjeve të kundërshtuara nga 2A GROUP SH.P.K., arsyetimin konkret teknik dhe operacional që ka çuar në përcaktimin e parametrave përkatës.

6.- FSHESA 1.5-1.9 TON PËR SHTIGJET E BIÇIKLETAVE DHE TROTUARET

2A GROUP kërkon që interвали i peshës të ndryshohet dhe të zgjerohet.

Autoriteti Kontraktues nuk e pranon këtë pretendim.

Kërkesa aktuale është: fshesë për pastrimin e shtigjeve të biçikletave dhe trotuareve me peshë totale minimum 1.5 dhe maksimum 1.9 ton, me sistem furça dhe vakum, kapacitet depozitimi minimum 240 L, gjerësi pune me brusha mbi 1.5 m dhe rezervuar uji mbi 150 L. Kjo pajisje nuk është kërkuar thjesht për të pastruar një sipërfaqe të zakonshme rrugore. Ajo është kërkuar për një funksion të veçantë: qasjen dhe pastrimin efikas të shtigjeve të biçikletave dhe trotuareve me hapësirë të kufizuar. Në praktikën operative të AK-së, këto sipërfaqe kërkojnë mjet kompakt dhe shumë të manovrueshëm. Në veçanti, në segmentet e shtigjeve të biçikletave dhe trotuareve të rrjetit qendror, gjerësia e shtegut në pjesë të ndryshme është rreth 1.5-1.9 m. Këto përmasa duhet të verifikohen dhe, për përdorim në dosje, të dokumentohen me matje të datuara në terren dhe/ose me matje nga burim zyrtar gjeohapësinor. Kufiri maksimal prej 1.9 ton është

vendosur me qëllim që të sigurohet një mjet i kategorisë kompakte, të përshtatshëm për kushtet konkrete të shtigjeve dhe hapësirave të kufizuara urbane, dhe nuk është vendosur për të përjashtuar ndonjë prodhues, markë apo model të caktuar. Çdo operator ekonomik është i lirë të propozojë prodhuesin dhe modelin që dëshiron, përderisa pajisja përmbush parametrat e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Po ashtu, kërkesa për gjerësi pune me brusha mbi 1.5 m lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të mbuluar në mënyrë sa më efektive sipërfaqen e shtegut, ndërsa rezervuari i ujit mbi 150 L lidhet me nevojën për kontrollin e pluhurit gjatë procesit të pastrimit. Pretendimi i 2A GROUP për zgjerimin e intervalit të peshës nuk shoqërohet me ndonjë provë konkrete se një fshesë më e rëndë është funksionalisht ekuivalente me mjetin e kërkuar nga AK në kushtet konkrete të shtigjeve të biçikletave dhe trotuareve të LOT-I. Vetëm deklarimi se një mjet më i rëndë mund të kryejë pastrimin nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar se ai mjet është i përshtatshëm për të gjitha hapësirat ku kërkohet ndërhyrja. Duhet të merret parasysh qasja, manovrueshmëria dhe dimensionet e hapësirës në të cilën mjeti duhet të operojë. Për më tepër, AK ka parasysh edhe sigurinë e përdoruesve të shtigjeve të biçikletave dhe këmbësorëve. Qëllimi nuk është vetëm që pastrimi të kryhet teknikisht, por që ai të realizohet pa krijuar pengesa të panevojshme dhe në mënyrë të përshtatshme për një ambient urban të frekuentuar. Për këtë arsye, AK nuk e konsideron të arsyeshme zgjerimin e intervalit të peshës vetëm mbi bazën e pretendimit të ankuesit, pa një dëshmi teknike konkrete që alternativa e propozuar garanton të njëjtin nivel funksionaliteti dhe përshtatshmërie për kushtet konkrete të LOT-I. Prandaj, duke marrë parasysh funksionin e pajisjes, karakteristikat e hapësirave ku ajo duhet të operojë dhe nevojën për manovrueshmëri e qasje në shtigjet e biçikletave dhe trotualet, Autoriteti Kontraktues e konsideron të arsyeshëm, të nevojshëm dhe të lidhur me objektin e kontratës intervalin 1.5–1.9 ton dhe e refuzon pretendimin e 2A GROUP për ndryshimin e tij.

7. FSHESA 2.0–2.7 TON PËR TROTUARE, RRUGË URBANE DHE HAPËSIRA PUBLIKE

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për fshesë kompakte me peshë totale minimum 2.0 dhe maksimum 2.7 ton përbën një kategori të veçantë të mekanizimit dhe nuk duhet të barazohet me kërkesën e pikës 2. Kjo ndarje është bërë për shkak se jo të gjitha hapësirat urbane që përfshihen në LOT-I kanë të njëjtën gjerësi, karakteristika, ngarkesë dhe funksion. Për këtë arsye, AK ka përcaktuar kategori të ndryshme të fshesave, të përshtatura me nevojat konkrete të shërbimit. Fshesa e kërkuar në këtë pikë, me peshë 2.0–2.7 ton, është paraparë për pastrimin e trotuareve, rrugëve urbane dhe hapësirave publike ku kërkohet një kompromis ndërmjet kapacitetit më të lartë të punës dhe manovrueshmërisë në ambient urban. Pretendimi i 2A GROUP se pesha duhet të ndryshohet dhe të jetë minimum 3 ton nuk shoqërohet me ndonjë arsyetim teknik konkret që do të dëshmonte se një pajisje nën 3 ton nuk mund ta realizojë funksionin për të cilin është kërkuar. Përkundrazi, vetë kërkesa e AK-së është përcaktuar në mënyrë funksionale, duke lejuar një interval nga 2.0 deri në 2.7 ton, çka i jep operatorëve ekonomikë hapësirë për të ofruar pajisje të ndryshme brenda kësaj kategorie, përderisa ato përmbushin kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. 2A GROUP nuk ka paraqitur provë konkrete se minimumi prej 3 ton është teknikisht i domosdoshëm për realizimin e shërbimit, dhe as nuk ka dëshmuar se pajisjet me peshë nga 2.0 deri në 2.7 ton nuk janë në gjendje ta kryejnë funksionin e kërkuar. Për këtë arsye, kërkesa për rritjen e kufirit minimal nga 2.0 ton në 3 ton nuk mund të mbështetet vetëm në një vlerësim të përgjithshëm të operatorit ekonomik se një makineri më e rëndë do të ishte e përshtatshme. Autoriteti Kontraktues, gjatë përcaktimit të kësaj kategorie, ka marrë parasysh nevojën që pajisja të ketë kapacitet të mjaftueshëm për pastrimin e sipërfaqeve të përcaktuara, por njëkohësisht të ruajë karakteristikat e nevojshme për operim dhe manovrim në hapësirat urbane. Prandaj, përcaktimi i intervalit 2.0–2.7 ton nuk është bërë për të përjashtuar operatorë ekonomikë apo prodhues të caktuar, por për të siguruar që pajisja e ofruar t'i përshtatet funksionit për të cilin është kërkuar. Fakti që në treg mund të ekzistojnë pajisje me peshë 3 ton ose më shumë nuk përbën dëshmi se ato janë më të përshtatshme për nevojën konkrete të LOT-I. Po ashtu, ekzistenca e një pajisjeje tjetër me parametra të ndryshëm nuk e detyron AK-në që të ndryshojë kërkesën e saj, përderisa pajisja e kërkuar është përcaktuar mbi bazën e nevojës së kontratës. AK thekson se në këtë pikë nuk është kërkuar një makineri me kapacitet maksimal të mundshëm, por një makineri e përshtatshme për kushtet konkrete të operimit urban, ku kapaciteti dhe manovrueshmëria duhet të jenë të balancuara. Për më tepër, kërkesa për minimum 3 ton, e propozuar nga

ankuesi, nuk është shoqëruar me ndonjë dëshmi se rritja e peshës nga 2.0–2.7 ton në minimum 3 ton do të sillte ndonjë përmirësim të domosdoshëm të shërbimit që kërkohej me këtë kontratë. Për rrjedhojë, nuk është e mjaftueshme që ankuesi të propozojë një kufi tjetër teknik; ai duhet të argumentojë pse kufiri i përcaktuar nga AK nuk e përmbush nevojën konkrete të kontratës. Në rastin konkret, një dëshmi e tillë nuk është paraqitur. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh funksionin e kësaj pajisjeje, karakterin urban të territorit dhe nevojën për kombinimin e kapacitetit me manovrueshmërinë, Autoriteti Kontraktues e konsideron të arsyeshëm dhe të nevojshëm intervalin 2.0–2.7 ton dhe nuk gjen bazë teknike për ndryshimin e tij në minimum 3 ton

8.– KAMIONETA PËR BARTJEN E MBETURINAVE URBANE, 3.5–4.5 TON

Dosja e korrigjuar kërkon kamionetë për bartjen e mbeturinave urbane me peshë totale minimum 3.5 dhe maksimum 4.5 ton, me karrocieri/kuti të mbyllur, kapacitet ngarkese të përshtatshëm për operim urban dhe sistem efikas ngarkimi/shkarkimi.

Kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me mënyrën konkrete të grumbullimit të mbeturinave nga shportat urbane dhe me nevojën që mbeturinat, pas grumbullimit, të transportohen në mënyrë të mbyllur dhe të sigurt, pa mundësi të shpërndarjes së tyre gjatë lëvizjes së automjetit. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar këtë kategori të mjetit duke pasur parasysh kushtet konkrete të operimit në LOT-I dhe nevojën për një mjet që mund të operojë në ambient urban, të kryejë grumbullimin dhe transportin e mbeturinave dhe njëkohësisht të sigurojë mbylljen e ngarkesës. Fakti që në një LOT tjetër mund të jetë përdorur një interval tjetër i peshës nuk e bën automatikisht të paligjshëm intervalin e përcaktuar për LOT-I. Secili LOT ka territor, dendësi, rrjet rrugor dhe nevoja operative të ndryshme. Për rrjedhojë, krahasimi i bërë nga ankuesi me kërkesat e përcaktuara në LOT-e të tjera nuk është, në vetvete, dëshmi se kërkesa e LOT-I është e panevojshme apo joproporcionale. Në rastin konkret, AK ka vlerësuar nevojën për një mjet të përshtatshëm për grumbullimin e mbeturinave urbane në territorin që mbulohet nga LOT-I dhe ka përcaktuar intervalin 3.5–4.5 ton si kategori të përshtatshme për këtë funksion. Kërkesa për karrocieri/kuti të mbyllur është gjithashtu e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit. Qëllimi është që mbeturinat e grumbulluara nga shportat urbane të transportohen pa u shpërndarë në rrugë dhe hapësira publike gjatë lëvizjes së mjetit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në territorin qendror të qytetit, ku ekziston frekuentim i lartë i këmbësorëve dhe qarkullim i konsiderueshëm i automjeteve dhe ku shpërndarja e mbeturinave gjatë transportit do të krijonte nevojë për ndërhyrje shitesë dhe do të cenonte cilësinë e shërbimit të mirëmbajtjes. Për këtë arsye, kërkesa nuk është përcaktuar vetëm mbi bazën e peshës së mjetit, por në lidhje me funksionin që duhet të realizojë mjeti dhe mënyrën e sigurt të transportimit të mbeturinave urbane. Gjithashtu, AK nuk e ka kufizuar operatorin në një markë, prodhues apo model të caktuar. Kërkesa është përcaktuar përmes karakteristikave dhe kapaciteteve që duhet t'i përmbushë mjeti. Prandaj, fakti që operatori mund të posedojë ose të propozojë një mjet me parametra të tjerë nuk përbën arsye të mjaftueshme që AK të ndryshojë kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit. Në mungesë të një prove konkrete teknike se intervali 3.5–4.5 ton nuk është i përshtatshëm për funksionin e kërkuar në LOT-I, kërkesa e ankuesit mbetet vetëm një propozim alternativ dhe jo dëshmi e ndonjë shkeljeje nga ana e AK-së. Për rrjedhojë, duke marrë parasysh natyrën e shërbimit, mënyrën e grumbullimit të mbeturinave urbane, nevojën për transport të mbyllur dhe kushtet konkrete të operimit në LOT-I, Autoriteti Kontraktues e konsideron të arsyeshëm dhe të nevojshëm intervalin 3.5–4.5 ton dhe nuk gjen bazë për ndryshimin e tij.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik për këtë pikë refuzohet.

9.– KOMBI SPECIAL PËR DEBLOKIM DHE PASTRIM TË KANALIZIMIT ATMOSFERIK

Autoriteti Kontraktues nuk e pranon pretendimin e Operatorit Ekonomik për ndryshimin e specifikimeve të kombit të kanalizimit atmosferik, pasi kërkesa është përcaktuar në bazë të nevojave konkrete të shërbimit dhe kushteve të operimit në LOT-I.

Kombi i kanalizimit është kërkuar për realizimin e shërbimeve të pastrimit të grilave, pusetave dhe elementeve të kanalizimit atmosferik, të cilat janë pjesë e rëndësishme e mirëmbajtjes së infrastrukturës publike në territorin që mbulohet nga LOT-I. Kërkesa për një kombi me peshë 3.5–5 ton është përcaktuar duke pasur parasysh nevojën që mjeti të jetë i përshtatshëm për operim në rrugët dhe hapësirat urbane ku

duhet të kryhet shërbimi, duke ruajtur njëkohësisht kapacitetin e nevojshëm për realizimin e punëve të parapara. Nga përvoja e realizimit të kontratave të mëparshme në këtë fushë është evidentuar nevoja që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një mjet të përshtatshëm edhe për rrugët më të ngushta dhe hapësirat ku mjetet më të mëdha nuk mund të kenë qasje të përshtatshme. Pikërisht për këtë arsye është kërkuar një kombi i kësaj kategorie dhe jo një automjet i rëndë që do të mund të krijonte kufizime në qasjen në pjesë të caktuara të territorit. Qëllimi i kësaj kërkesë nuk është vetëm posedimi formal i një automjeti, por sigurimi i kapacitetit real për kryerjen e shërbimit të pastrimit të kanalizimit atmosferik në të gjithë territorin e LOT-I. Në këtë kuptim, Autoriteti Kontraktues nuk mund të mbështetet vetëm në mundësinë teorike që një mjet tjetër mund të kryejë një pjesë të shërbimit. Duhet të sigurohet që mjeti i kërkuar të jetë në gjendje të kryejë punën në kushtet konkrete të terrenit dhe në të gjitha lokacionet ku mund të kërkohej ndërhyrja. Po ashtu, parametrat teknikë të përcaktuar për këtë pajisje, përfshirë parametrat që lidhen me sistemin e pastrimit, nuk janë vendosur në mënyrë arbitrare. Ato lidhen me nevojën që mjeti të ketë fuqi dhe kapacitet të mjaftueshëm për të kryer punën e kërkuar, në mënyrë që gjatë realizimit të kontratës operatori të mos mund të arsyetohet se pajisja nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për ndërhyrjen e kërkuar. E njëjta logjikë vlen edhe për kërkesën lidhur me gjatësinë e gypave. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me kushtet reale të operimit në qytet. Në shumë raste, mjeti nuk mund të pozicionohet drejtpërdrejt pranë pusëtës apo grilës që duhet të pastrohet, për shkak të strukturës së rrugës, trotuareve, automjeteve të parkuara, qarkullimit dhe karakteristikave të hapësirës urbane. Për këtë arsye, gjatësia minimale e kërkuar e gypave është përcaktuar për të mundësuar që operatori të kryejë shërbimin edhe atëherë kur mjeti duhet të qëndrojë në një distancë nga pika konkrete e ndërhyrjes. Kjo kërkesë nuk është një parametër i vendosur për kufizimin e konkurrencës, por një kërkesë që rrjedh nga mënyra praktike e realizimit të shërbimit. Autoriteti Kontraktues duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të kontratës operatori ekonomik të mos mund të paraqesë pengesa të tilla si: "mjeti nuk mund të afrohet", "gypi nuk arrin deri te puseta", "mjeti nuk ka kapacitet të mjaftueshëm" ose "nuk mund të realizohet ndërhyrja në këtë lokacion". Pikërisht për këtë arsye janë përcaktuar parametra minimalë teknikë, të cilët synojnë të sigurojnë që pajisja e kontraktorit të jetë realisht funksionale për shërbimin që duhet të realizohet. Për më tepër, pastrimi dhe mirëmbajtja e kanalizimit atmosferik ka rëndësi të veçantë për funksionimin normal të infrastrukturës së qytetit, veçanërisht në rastet e reshjeve intensive, ku funksionimi i rregullt i grilave dhe kanaleve atmosferike është i domosdoshëm për reduktimin e rrezikut të grumbullimit të ujit dhe përmblyetjeve. Prandaj, AK nuk mund ta pranojë propozimin që këto kërkesa të reduktohen ose të ndryshohen vetëm mbi bazën e pretendimit të operatorit ekonomik, pa u dëshmuar se pajisja alternative do të ofrojë të njëjtin nivel të kapacitetit, qasjes dhe funksionalitetit. Në rastin konkret, ankuesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi konkrete që do të provonte se parametrat e përcaktuar nga AK janë të panevojshëm për realizimin e shërbimit. Përkundrazi, kërkesat janë të lidhura drejtpërdrejt me funksionin e pajisjes dhe me kushtet në të cilat ajo duhet të operojë. Për këto arsye, Autoriteti Kontraktues e konsideron të arsyeshme, të nevojshme dhe të lidhur me objektin e kontratës kërkesën për kombin e kanalizimit atmosferik dhe parametrat e tij teknikë dhe e refuzon pretendimin e Operatorit Ekonomik për ndryshimin e tyre.

10.- KAMION CISTERNË SPECIAL 9,000-20,000 L

Autoriteti Kontraktues kërkon kamion cisternë special me mekanizëm komplet për thithje dhe deblokim, i cili mund të ndahet në minimum 4,500 L për thithje dhe minimum 4,500 L për deblokim, me kapacitet total minimum 9,000 L dhe maksimum 20,000 L, presion minimum 120 bar, gyp për deblokim minimum 50 m dhe gyp për thithje minimum 7 m.

2A GROUP e krahason këtë mjet me fshesën 7-12 ton dhe pretendon se, nëse për këtë pajisje lejohet një kapacitet dhe dimension më i madh, atëherë nuk ekziston arsye për kufizimin e peshës së fshesave.

Ky krahasim nuk qëndron teknikisht. Kapaciteti volumetrik i një kamioni cisternë dhe pesha totale e një fshese rrugësh janë parametra që lidhen me mjete me funksione dhe mënyra operimi të ndryshme. Kamioni cisternë special kërkohej për një funksion të specializuar, përkatësisht thithjen dhe deblokimin e kanalizimit atmosferik, ndërsa fshesa rrugore përdoret për pastrimin mekanik të sipërfaqes së rrugës. Një cisternë me kapacitet të madh kërkohej pikërisht për transportimin dhe thithjen e një sasive të konsiderueshme të ujit,

sedimentit dhe mbetjeve nga infrastruktura e kanalizimit. Kjo nuk nënkupton se i njëjti dimension dhe tonazh është optimal për pastrimin mekanik të sipërfaqes së rrugës në trafik urban. Për këtë arsye, fakti që AK ka lejuar një kamion cisternë me kapacitet deri në 20,000 L nuk mund të përdoret si argument për heqjen ose ndryshimin e kufirit të peshës së fshesave rrugore. Funkcioni, konstruksioni dhe mënyra e operimit të këtyre mjeteve janë të ndryshme. Kërkesa për ndarjen e kapacitetit në minimum 4,500 L për thithje + 4,500 L për deblokim është përcaktuar për të siguruar që mjeti të ketë kapacitet real për t'i kryer të dy funksionet e kontratës dhe jo vetëm njërin prej tyre. Në të njëjtën mënyrë, kërkesa për presion minimum 120 bar dhe për gjatësinë minimale të gypave lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e mjetit për të kryer ndërhyrjet e kërkuara në pusetat dhe rrjetin e kanalizimit atmosferik. Kërkesa për gyp minimum 50 m për deblokim dhe minimum 7 m për thithje është përcaktuar në funksion të mënyrës reale të operimit dhe qasjes në pikat ku duhet të kryhet shërbimi. Prandaj, maksimumi 20,000 L nuk është kërkesë për çdo mjet të kontratës dhe nuk përbën bazë për heqjen e kufirit të fshesave. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar secilën pajisje në bazë të funksionit që duhet të kryejë dhe kushteve në të cilat duhet të operojë. Për rrjedhojë, krahasimi i bërë nga 2A GROUP ndërmjet kapacitetit të cisternës dhe peshës së fshesës rrugore nuk paraqet një krahasim teknikisht të krahasueshëm dhe nuk dëshmon se kufizimi i fshesave është i panevojshëm. Për këto arsye, pretendimi i Operatorit Ekonomik për këtë pikë refuzohet.

11. PËRSE MAKSIMUMI 12 TON PËR FSHESET E RRUGËVE KRYESORE NUK ËSHTË I PAARSYESHËM

Autoriteti Kontraktues sqaron se nuk pretendon se një fshesë rrugore mbi 12 ton është teknikisht e paaftë për të kryer pastrimin e rrugëve. Çështja që duhet të vlerësohet është nëse një mjet i tillë është i nevojshëm dhe proporcional për shërbimin konkret që duhet të realizohet në rrjetin urban të LOT-I. Rrugët kryesore dhe bulevardet që përfshihen në LOT-I janë pjesë e një sistemi urban me trafik të konsiderueshëm, ku mjeti i pastrimit duhet ta kryejë shërbimin pa krijuar pengesa të panevojshme dhe pa rënduar komunikacionin. Një automjet me dimensione dhe peshë më të madhe mund të ketë rreze kthimi më të madhe, zënie më të madhe të hapësirës rrugore dhe kërkesa më të mëdha operative. Këto janë faktorë relevantë për një shërbim që realizohet në rrugë urbane aktive. Për këtë arsye, AK nuk ka pasur për qëllim të kërkojë mjetin më të madh që ekziston në treg, por një mjet që ofron kapacitet të mjaftueshëm për pastrimin e rrugëve kryesore dhe bulevardeve, duke qenë njëkohësisht i përshtatshëm për kushtet konkrete të trafikut urban. Në këtë kuptim, maksimumi 12 ton duhet të lexohet së bashku me përshkrimin funksional të pajisjes: fshesë për rrugë kryesore dhe bulevarde, me sistem furçash dhe vakum me fuqi të lartë dhe e përshtatshme për operim në zona me trafik të lartë. Pra, kufiri maksimal nuk është vendosur në mënyrë të shkëputur nga funksioni i pajisjes. Ai është pjesë e përcaktimit të kategorisë së mjetit që AK e konsideron të përshtatshëm për kushtet konkrete të LOT-I. Fakti që ekzistojnë në treg fshesa me peshë mbi 12 ton nuk e detyron AK-në që t'i pranojë ato, nëse nga vlerësimi i nevojave konkrete të kontratës rezulton se një kategori më e madhe e mjetit nuk është e nevojshme për realizimin e shërbimit. Në rastin konkret, AK do ta mbështesë këtë vlerësim edhe me listën e rrugëve të përfshira në LOT-I, në mënyrë që kërkesa të jetë e verifikueshme dhe e lidhur me territorin konkret për të cilin është hartuar kontrata. Kjo e bën dallimin ndërmjet një kufizimi të vendosur në mënyrë subjektive dhe një kufizimi të vendosur mbi bazën e kushteve konkrete të operimit në territorin e LOT-I. Prandaj, kërkesa për maksimum 12 ton nuk duhet të interpretohet si përjashtim i një teknologjie të caktuar, por si përcaktim i kategorisë së mjetit që AK e konsideron të përshtatshëm për kombinimin e kërkesave të pastrimit, kapacitetit, manovrueshmërisë dhe operimit në trafik urban. Autoriteti Kontraktues vlerëson se kjo kërkesë është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me kushtet konkrete të realizimit të shërbimit në LOT-I. Për rrjedhojë, kërkesa për heqjen e kufirit maksimal prej 12 ton nuk pranohet dhe pretendimi i Operatorit Ekonomik për këtë pikë refuzohet.

12. LIBREZA DHE REGJISTRIMI VALID - PSE KËRKESA NUK PËRBËN BARRIERË ABSOLUTE

2A GROUP pretendon se kërkesa që disa fshesa të jenë të pajisura me librezë dhe regjistrim valid gjatë fazës së vlerësimit krijon barrë financiare dhe administrative për operatorët ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk e pranon këtë pretendim.

Kërkesa për librezë dhe regjistrim valid nuk është vendosur për të favorizuar ose përjashtuar një operator ekonomik të caktuar, por për të siguruar që pajisja e deklaruar në ofertë të jetë mjet real, i identifikueshëm dhe i regjistruar në mënyrë të vlefshme, dhe jo vetëm një pajisje e deklaruar në mënyrë formale. Kjo kërkesë duhet të vlerësohet në kontekstin e natyrës së kontratës. Pajisjet për të cilat kërkohet regjistrim janë mjete që do të përdoren në hapësira publike dhe në rrjetin rrugor urban, prandaj AK ka interes legjitim që të sigurohet se mjetet që do të përdoren për realizimin e kontratës janë mjete reale dhe të identifikueshme. Kërkesa për dokumentacion valid nuk nënkupton që AK po kërkon një markë, prodhues apo operator të caktuar. Çdo operator ekonomik mund të ofrojë pajisje që përmbushin specifikimet teknike dhe kërkesat dokumentare të Dosjes së Tenderit. Për më tepër, pretendimi se kjo kërkesë krijon automatikisht një barrierë financiare apo administrative nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar se kërkesa është e panevojshme. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë konkretisht se kërkesa është e palidhur me objektin e kontratës ose se e pamundëson në mënyrë të pajustificuar pjesëmarrjen në procedurë. Në rastin konkret, lidhja ndërmjet dokumentacionit të mjetit dhe objektit të kontratës është e drejtpërdrejtë, pasi pajisjet do të përdoren për kryerjen e shërbimeve në rrugë, trotuare dhe hapësira publike. Për këtë arsye, AK ka të drejtë të kërkojë dokumentacion që mundëson verifikimin e ekzistencës, identifikueshmërisë dhe statusit të mjetit të deklaruar. Gjithashtu, kërkesa nuk duhet të interpretohet si detyrim për të poseduar një mjet të një marke apo modeli të caktuar. Kriteri është i njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe zbatohet në mënyrë të barabartë ndaj çdo ofertuesi. Qëllimi i kësaj kërkesë është verifikimi i ofertës dhe garantimi i seriozitetit të kapaciteteve të deklaruara, jo kufizimi i konkurrencës. Për rrjedhojë, fakti që një operator ekonomik mund të ketë një barrë administrative për sigurimin e dokumentacionit nuk është, në vetvete, arsye që kërkesa të eliminohet, përderisa dokumentacioni kërkohet në lidhje me pajisjen që do të përdoret për realizimin e kontratës. Autoriteti Kontraktues vlerëson se kjo kërkesë është e lidhur me objektin e kontratës dhe me nevojën për verifikimin e kapaciteteve reale të operatorit ekonomik. Prandaj, pretendimi i 2A GROUP për eliminimin e kërkesës për librezë dhe regjistrim valid nuk pranohet dhe kërkesa mbetet në fuqi.

13. KRITERI 60% PËR LIDERIN E GRUPIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË

Autoriteti Kontraktues nuk e pranon pretendimin e Operatorit Ekonomik se kërkesa që lideri i grupit të Operatorëve Ekonomikë të përmbushë së paku 60% të kërkesës së përcaktuar për pajisje/makineri është në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së.

Sipas nenit 69 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë dëshmi për aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, duke përfshirë, sipas natyrës, sasisë dhe qëllimit të shërbimit, deklaratën e mjeteve, pajisjeve dhe kapaciteteve teknike në dispozicion për realizimin e shërbimit.

Në mënyrë specifike, pika 26.10 e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton se, kur është e nevojshme, Autoritetet Kontraktuese mund të përcaktojnë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë se si grupet e Operatorëve Ekonomikë duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuara në nenet 68 dhe 69 të LPP-së, duke lejuar përcaktimin e një përqindjeje minimale në drejtim të përmbushjes së kërkesave nga lideri i grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Për rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi se vetë përcaktimi i një përqindjeje minimale për liderin është i ndaluar nga neni 71 i LPP-së. Përkundrazi, legjislacioni dytësor i prokurimit e njeh shprehimisht këtë mundësi.

Autoriteti Kontraktues e ka përcaktuar pragun prej 60% jo për të eliminuar konsorciumet, por për të siguruar që partneri udhëheqës i grupit të ketë një kapacitet substancial dhe real teknik për realizimin e kontratës.

Kjo kërkesë është veçanërisht e arsyeshme në rastin konkret për shkak të natyrës së shërbimeve të LOT-I, i cili përfshin territorin qendror të Prishtinës dhe kërkon përdorim të një numri të konsiderueshëm dhe të larmishëm të makinerive për fshirje, pastrim, larje, mirëmbajtje të rrugëve, trotuareve, shtigjeve të biçikletave, hapësirave publike dhe kanalizimit atmosferik.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të pranojë një strukturë grupi në të cilën lideri nuk ka asnjë kapacitet real në pajisjet kryesore të kërkuara, ndërsa i gjithë kapaciteti teknik i kontratës mbështetet vetëm në anëtarë

të tjerë të grupit. Një strukturë e tillë, në rrethanat konkrete të kësaj kontrate, do ta dobësonte rolin real të partnerit udhëheqës dhe do të krijonte rrezik për koordinimin, mobilizimin dhe vazhdimësinë e shërbimeve. Prandaj, pragu prej 60% është vendosur si masë e kapacitetit minimal të liderit, duke ruajtur njëkohësisht mundësinë që pjesa tjetër e kapacitetit të plotësohet përmes anëtarëve të tjerë të grupit ose kapaciteteve të lejuara sipas legjislacionit.

Kërkesa është publikuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dhe zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë. Ajo nuk i referohet ndonjë marke, prodhuesi, modeli apo operatori të caktuar, por vetëm nivelit minimal të kapacitetit teknik që duhet të mbartë lideri.

Rrjedhimisht, pretendimi i ankuesit se kërkesa prej 60% është në vetovetë në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së refuzohet si i pabazuar.

14. KRAHASIMI ME LOTET E TJERA NUK ËSHTË PROVË E DISKRIMINIMIT

2A GROUP përdor disa krahasime ndërmjet LOT-I, LOT-II, LOT-III, LOT-IV dhe LOT-V, duke pretenduar se, për shkak se një makinë e njëjtë ose e ngjashme është kërkuar me parametra të ndryshëm në lote të ndryshme, edhe LOT-I duhet të ketë të njëjtat parametra.

Autoriteti Kontraktues nuk e pranon këtë premisë.

Vetë ndarja e aktivitetit të prokurimit në lote është bërë për të menaxhuar territore, nevoja dhe kushte operative të ndryshme. Për rrjedhojë, fakti që një pajisje e njëjtë ose e ngjashme është specifikuar ndryshe në një LOT tjetër nuk përbën, në vetovetë, dëshmi se specifikimi i LOT-I është diskriminues ose i panevojshëm.

LOT-I ka karakteristika konkrete operative dhe mbulon territorin qendror dhe zonat kryesore urbane të Prishtinës, duke përfshirë rrugë kryesore, bulevarde, trotuare, hapësira publike, segmente me shtigje biçikletash, rrugë urbane me karakteristika të ndryshme, pika të grumbullimit të mbeturinave dhe infrastrukturë të kanalizimit atmosferik.

Për këtë arsye, AK nuk mund të detyrohet që të përdorë të njëjtat parametra për çdo LOT vetëm për shkak se një kategori makinerie ka emërtim të njëjtë ose funksion të ngjashëm.

Parametri teknik duhet të vlerësohet në raport me nevojën konkrete të LOT-it për të cilin është kërkuar, dhe jo vetëm përmes një krahasimi numerik me një LOT tjetër.

Një diferencë ndërmjet specifikimeve të loteve nuk është vetvetiu diskriminim. Për të provuar një shkelje, ankuesi duhet të tregojë se diferenca konkrete nuk ka lidhje me objektin, funksionin ose nevojën e LOT-it përkatës. Një krahasim vetëm numerik ndërmjet dy specifikimeve nuk e dëshmon këtë.

Në rastin konkret, dallimet në parametrat e pajisjeve lidhen me funksionet e ndryshme që duhet të mbulohen, karakteristikat e territorit dhe kushtet operative të secilit LOT.

Për shembull, fakti që një fshesë mund të ketë një interval tjetër peshe në një LOT tjetër nuk dëshmon se i njëjti interval duhet të aplikohet në LOT-I. Njësoj, fakti që një pajisje më e madhe mund të jetë e përshtatshme në një territor tjetër nuk dëshmon se ajo është zgjidhja më e përshtatshme për territorin qendror të Prishtinës.

AK nuk është i detyruar të standardizojë artificialisht parametrat e të gjitha loteve, nëse nevojat operative që duhet të përmbushen nuk janë të njëjta.

Përkundrazi, standardizimi i detyruar i parametrave vetëm për shkak të një krahasimi me LOT-et e tjera mund të çojë pikërisht në një rezultat të kundërt me nevojën reale të kontratës, sepse do të detyronte AK-në të përdorte të njëjtën kategori mekanizimi edhe në territore me karakteristika të ndryshme.

Në këtë procedurë, AK ka vepruar në mënyrë të kundërt: ka përcaktuar mekanizimin në bazë të funksionit dhe kushteve konkrete të operimit, duke pranuar se nevojat e territorit nuk janë identike.

Për më tepër, krahasimi i 2A GROUP me LOT-et e tjera nuk paraqet ndonjë analizë teknike që do të dëshmonte se parametrat e LOT-I nuk janë të nevojshëm. Ankuesi nuk mund të zëvendësojë këtë analizë vetëm me një tabelë krahasuese të parametrave.

Një krahasim numerik nuk është provë teknike e mungesës së nevojës.

Për të kundërshtuar në mënyrë të bazuar një kërkesë teknike të LOT-I, do të duhej të dëshmohej konkretisht se parametri i kërkuar nuk është i lidhur me funksionin e pajisjes, nuk është i nevojshëm për kushtet e operimit ose krijon një kufizim të panevojshëm të konkurrencës. Një dëshmi e tillë nuk është paraqitur.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues vlerëson se dallimet ndërmjet parametrave të pajisjeve në lote të ndryshme janë të justifikuara nga nevojat konkrete të secilit LOT dhe nuk përbëjnë, në vetvete, diskriminim ndaj operatorëve ekonomikë. Rrjedhimisht, kërkesa e 2A GROUP që parametrat e LOT-I të harmonizohen me parametrat e loteve të tjera nuk pranohet, pasi nuk është dëshmuar se kjo diferencë është e palidhur me objektin dhe nevojat konkrete të LOT-I. Pretendimi refuzohet.

15. TENDERI I VITIT 2023 DHE PËRVOJA E AK-së

AK mund të marrë parasysh përvojën e procedurave dhe kontratave të mëparshme si burim për vlerësimin e nevojave, por jo si zëvendësim të arsytimit aktual. Në dokumentacionin e vitit 2023 janë përdorur kategori të ndryshme të mekanizimit për mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave urbane. Kjo dëshmon se nevoja për mekanizim të diferencuar nuk është krijuar rishtazi me këtë procedurë.

16. PËRGJIGJJA NDAJ PRETENDIMIT PËR SHKELJE TË NENEVE 1, 6 DHE 7 TË LPP-së

Pretendimi se kërkesat shkelin qëllimin e LPP-së, economicitetin, efikasitetin dhe barazinë në trajtim nuk qëndron. Neni 6 kërkon përdorimin ekonomik të fondeve duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Një pajisje që është më e lirë ose më e madhe nuk është automatikisht më ekonomike nëse nuk e realizon funksionin e kërkuar në mënyrën më efikase. Neni 7 ndalon favorizimin dhe diskriminimin. AK nuk ka identifikuar prodhues, markë, origjinë ose model të caktuar. Kërkesat janë përshkruar përmes parametrave teknikë dhe funksionalë dhe janë të aplikueshme në mënyrë të njëjtë për çdo operator që i plotëson. Fakti që një operator ekonomik mund të ketë nevojë të sigurojë një pajisje për të përmbushur një kërkesë të ligjshme dhe të parashpallur nuk e bën kërkesën diskriminuese. Përndryshe, çdo kërkesë për kapacitet teknik do të mund të kundërshtohej vetëm mbi bazën se një operator nuk e posedon atë pajisje.

17. PËRGJIGJJA NDAJ PRETENDIMIT PËR NENIN 27 DHE RREGULLOREN 001/2022

Neni 27 kërkon që AK të përgatisë Dosjen e Tenderit me kushtet materiale dhe specifikimet teknike. Kjo procedurë është zhvilluar pikërisht nëpërmjet një Dosjeje të Tenderit të publikuar dhe të korrigjuar.

Rregullorja 001/2022, Neni 19, kërkon që specifikimet të jenë të qarta, të sakta dhe precize, por nuk e ndalon AK-në të përcaktojë parametra teknikë kur këta janë të lidhur me funksionin, performancën, dimensionet ose sigurinë e objektit. Në këtë procedurë, parametrat janë shoqëruar me përshkrimin e përdorimit të pajisjes. Kjo e bën dallimin ndërmjet kategorive të mekanizimit të kuptueshëm dhe të verifikueshëm".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.09.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.